

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                     |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Nga Genc Burimi - Prezumimi i pafajësisë sipas Ramës dhe sipas njerkes                                                                                                                              |
| ADRESA  | <a href="https://www.syri.net/politike/919578/prezumimi-i-pafajesise-sipas-rames-dhe-sipas-njerkes/">https://www.syri.net/politike/919578/prezumimi-i-pafajesise-sipas-rames-dhe-sipas-njerkes/</a> |
| BURIMI  | syri.net                                                                                                                                                                                            |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                              |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 27 shtator 2026, 20:02:40 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 19:20:54 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 00daeb91daa8e24250047245a336e166e1434c7dfe6e3c22fe5a277ceff91856 |
| TEKSTI     | 99d7609bcab433513285ecb20e6c809c025f4487460ed6015091ed53f6a6d5fb |
| PAMJA      | 5641a91d82f42c6be4d709152dc3b104c5d585d58b50e023ea393d11a43a17b9 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 271842d98bee4df5474e34459daf4a9ec011998affa67679ab302065fc29cbc6                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/271842d98bee4df5474e34459daf4a9ec011998affa67679ab302065fc29cbc6>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





**ÇIM PEĐA**  
'Nuk e dija, nuk mjafton më'



**FATMIR MEDIU**  
Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk i kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



## më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më

'Asnjë hap pas' / Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!

VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlorë Hysenit?

Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?

Berisha: Vlorë Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan


Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë



## Prezumimi i pafajësisë sipas Ramës dhe sipas njerkes

21:20, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



**Nga Genc Burimi**

Në vend që të kërkonte falje e të përgjigjej për dëmet e pallogaritshme që po pëson vendi nga ata persona që vetë i emëron, Kryeministri preferoi kakarisjen nga aeroporti, me leksione sesi duhet të sillen drejtësia dhe mediat ndaj të pandehurve 'made in Ramaland'.

Mos e dënioni mediatikisht Vlorën, thotë Rama, pa proces të rregullt gjyqësor, se shkelet parimi i shenjtë i prezumimit të pafajësisë.

Ky që vetë ka shpallur të fajshëm sa e sa kundërshtarë politikë e mediatikë para Tribunalit të opinionit publik, pa prituri jo e jo dënimin e formës së prerë, por dhe vetë hapjen e një procesi.

Dhe kësaj here huqja iu rikthye me galop. Nuk priti as pesë minuta pasi mori gjerë e gjatë në mbrojtje Vlorën nga qentë e mediave, kur ky kryeministër të vetëbëhej prokuror dhe t'i shpallte, sipas kutit të tij, fajtorë për evazion fiskal televizionet që flasin kundër tij.

Kjo është të shohësh 'news'-e dhe qime të 'Syri'-t i të tjerëve, pa parë trarët e korrupsionit që i kanë zënë shikimin dhe frymën mbarë Shqipërisë.

Që ditën e parë të revolucionit kundër tij, Rama i shpalli protestuesit, me sigurinë e gjelit kakarritës që e karakterizon, si të shitur te Rusia apo Irani, pa pasur nevojë për hetimin e drejtësisë, sepse Ai di gjithçka.

Por për Vlorën dhe bëmat e saja ulëritëse, njerzia, sipas Kryeministrit, duhet ta qepë sqepin deri sa drejtësia t'i shkojë në fund, domethënë heshtje minimumi pesëvjeçare, sepse kështu e do kutia e Ramës.

Guxon të japë leksione drejtësie ky Kryeministër nga maja e aeroportit, me cinizmin më të lartë, kur poshtë këmbëve të tij, te poltroni i kakarisjes, mbante të shkelura me të dyja atletet vendimet e drejtësisë më përfundimtare që njeh një

vend, atë të Gjykatës Kushtetuese.

Te Rama, skena dhe prapaskena luheshin vertikalisht: Shteti sipërfaqësor i së drejtës në mikrofon, përtokë ai i së padrejtës, si zhele, në të njëjtën gjendje që ka lënë gjithë vendin.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Mbrojtji të drejtat e shqiptarëve në RMV, Denion Meidani çohet në Prishtinë, Petrit Malaj e zëvendëson në Shkup



Jo qindarka, por ja 21 plaçkitje miliona euro të Ramës për këdo, që i ka harruar dhe për të ndihmuar SPAK!



Protestuesit i përgjigjen Ramë për skandalet dhe korrupsionin: Krimi ka kokë!

‘Garancia e plotë’ e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlora Hysenin

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

‘Mos kujtoni se ju kam vjedhur’/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen

#### TË NGJASHME



VIDEO/ Qytetari: Rama asnjë takim të nivelit të lartë në OKB, por vetëm foli keq për popullin e tij



SYRI TV/ Abuzimet me konçensionet PPP, gati gjysma e pagesave nën hetim



‘Më 3 tetor diaspora protestë në Bruksel’/ Qytetari kërkesë për PE-në: Ndaloni takimet me Ramën



‘Spërdredhje bajate’/ Tomorrow: Sipas Ramës, partnerët u lemerisën se SPAK akuzoi shëfën e SHISH, jo se kë kishte emëruar ky



‘Mos kujtoni se ju kam vjedhur’/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen



Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?



Skandali i SHISH/ Muçollari: Rama do që krimi të mos merret vesh, jo që të mos ndodhë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione [info@syri.net](mailto:info@syri.net), për reklama [marketing@syri.net](mailto:marketing@syri.net)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.